



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 658/3 Prot.

Tiranë, më 30/07/2015

VENDIM

Nr. 45, datë 30/07/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Z. _____, përfaqësuar me prokurë Nr.690 Rep. dhe nr.334 Kol., nga Av. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr.658 Prot., datë 10.07.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Gramsh, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare". Ankuesi nëpërmjet shkresës të datës 26.05.2015, ka kërkuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh t'i vihet në dispozicion të njësuara me origjinalin kopje të dokumentacionit sipas objektit të kërkesës dhe më konkretisht:

1. Shkresën nr.60 prot., datë 03.02.2014 drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë.
2. Shkresën nr.403 prot., datë 24.07.2014 drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë si dhe aktet provuese apo procedurat që janë ndjekur për nxjerrjen e këtyre kërkesave.
3. Kontratën individuale të punës për Z.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga ankuesi rezulton se Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh ka vepruar në kundërshtim me nenin 15/1 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", në të cilin shprehimisht thuhet 1) "Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe". Në këtë rast mostrajtimi i kërkesës konsiderohet "refuzim" dhe për këtë ligji parashikon sanksionin përkatës.

Pas vlerësimit të ankesës së Z. _____, në përputhje me pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", Komisioneri me shkresën nr. 658/1 Prot., datë 14.07.2015, ka kërkuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh të paraqesë parashtrime me shkrim brenda datës 27.07.2015.

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh me shkresën nr.391 Prot., datë 24.07.2015 ka sqaruar se një kopje të kontratës individuale të punës, ia ka vënë në dispozicion kërkuarit në momentin e lidhjes së saj. Gjithashtu, bashkëlidhur shkresë së mësipërme i ka dërguar edhe një kopje të saj të njësuara me vulën e institucionit.

Në vijim të parashtrimeve, Autoriteti Publik/ Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gramsh, sqaron lidhur me pikën 1 dhe 2 të kërkesës, se shkresat e kërkuara janë depozituar pranë Ministrisë së Shëndetësisë. Në këtë rast rezulton se, Autoriteti Publik/Drejtoria e Shërbimit Spitalor

Gramsh në parashtrime ka anashkaluar faktin e mbajtjes së kopjes së çdo dokumenti në administrim të saj pavarësisht kalimit të tij për institucionin qendror, Ministrinë e Shëndetësisë, nga i cili edhe varet, me qëllim dhënien e tyre. Në të kundërt, rezulton se ka anashkaluar faktin e evidentimit të mungesës së informacionit të kërkuar (dy shkresave) si arsye e vetme që çon autoritetin publik/ Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh, në zbatimin e nenit 12/2 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit", sipas të cilit kjo drejtori duhej të kishte dërguar kërkesën për trajtim pranë autoritetit që disponon dokumentacionin e kërkuar.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës Nr.658 Prot., datë 10.07.2015 të Z. _____, përfaqësuar me prokurë Nr.690 Rep. dhe nr.334 Kol., nga Av. _____, kundër Autoriteti Publik/ Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Gramsh, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Gramsh, për vënien në dispozicion të kërkuarit kopje të njësuara me origjinalin të shkresave nr.60 prot., datë 03.02.2014 dhe nr.403 prot., datë 24.07.2014 drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, brenda datës 06.08.2015.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 30.07.2015.

